

AD-STAR sh.p.k.

Rr. Perlat Rexhei, Pallati Uniko, Kati 2, Ap. 10, Tiranë, Shqipëri

Kodi Postar: 1019 | Tel: +355 68 207 4215 | adstarkonstruksion@gmail.com

NUI: J69102207W | Përfaqësuesi: Alfred Çoma

Tiranë, 03.04.2026

Drejtuar: Organit Shqyrtues i Prokurimit Publik (OSHP)

Rr. "MIGJENI" (ish-Banka e Ljubljanes, Kati V-të)

10000 Prishtinë, Republika e Kosovës

oshp@rks-gov.net | Tel: +383 38 212 309

Lënda: ANKESË PRANË OSHP-SË — kundër Vendimit të Autoritetit Kontraktues datë 30.03.2026 — Nr. Prokurimi 207-25-9871-5-1-1 dhe 207-25-117-5-1-1 — Ministria e Kulturës, Rinisë dhe Sportit të Kosovës

I. PALËT DHE TË DHËNAT E PROCEDURËS

Ankuesi	AD-STAR sh.p.k.
NUI	J69102207W
Përfaqësuesi ligjor	Alfred Çoma
Adresa	Rr. Perlat Rexhei, Pallati Uniko, Kati 2, Ap. 10, Tiranë, Shqipëri
Autoriteti Kontraktues	Ministria e Kulturës, Rinisë dhe Sportit (MKRS)
Zyrtari nënshkrues	Valbone Zekaj, Zv. Drejtore / Zyra e Prokurimit
Nr. i Prokurimit	207-25-9871-5-1-1 dhe 207-25-117-5-1-1
Objekti i kontratës	Ndërhyrje restauruese dhe konservuese — Trashëgimia Kulturore, Rajoni i Pejës dhe Deçanit
Dorëzimi i Kërkesës për Rishqyrtim	23.03.2026
Data e Vendimit të AK per kerkesen per rishqyrtim	30.03.2026
Njoftim zgjatjeje afati nga AK (par. 6 Nenit 108/A)	Nuk pati njoftim per zgjatje afati te Pergjigjes nga AK
Data e kësaj Ankese	03.04.2026
Afati ligjor për ankesë në OSHP	09.04.2026 (10 ditë nga 30.03.2026)

II. KRONOLOGJIA DHE KONTEKSTI I ÇËSHTJES

AD-STAR sh.p.k. mori pjesë rregullisht në procedurën e prokurimit nr. 207-25-9871-5-1-1 dhe 207-25-117-5-1-1, me objekt: Ndërhyrje restauruese dhe konservuese në asetet e Trashëgimisë Kulturore në Rajonin e Pejës dhe Rajonin e Deçanit, shpallur nga Ministria e Kulturës, Rinisë dhe Sportit.

AD-STAR oferto në pesë (5) lote:

- Loti 1: 140.034,75 EUR — oferta me çmimin më të ulët
- Loti 2: 377.104,38 EUR — oferta me çmimin më të ulët
- Loti 3: 93.221,26 EUR — i vetmi pjesëmarrës
- Loti 4: 37.276,00 EUR
- Loti 5: 46.398,00 EUR

- ✓ Më datë 19.03.2026, AD-STAR u njoftua se eliminohej me arsyetimin se, në zbatim të Udhëzimit Administrativ nr. 16/2016, **inxhinierët nuk disponojnë vërtetim nostrifikimi të diplomave të fituara jashtë Kosovës.**
- ✓ Më datë 23.03.2026, AD-STAR parashitroi Kërkesë për Rishqyrtim pranë AK-së sipas Nenit 108/A të LPP-së me argumentin kryesor se **kriteri mbi bazën e të cilit ishte bërë eliminimi nuk ishte pjesë e Dosjes së Tenderit**
- ✓ Më datë 30.03.2026, AK nxori vendim refuzimi — të cilin AD-STAR e konteston si të paligjshëm proceduralisht dhe materialisht.

III. SHKELJET E PRETENDUARA

3.1 Shkelja e Nenit 108/A, Paragrafët 3 dhe 6 — Mosrespektim i afatit dhe mungesë njoftimi për zgjatje afati

Neni 108/A, Paragrafi 3 i LPP-së parashikon se AK duhet të vendosë mbi Kërkesën për Rishqyrtim brenda tre (3) ditëve nga pranimi. Kërkesa e AD-STAR u dorëzua më 23.03.2026. Rrjedhimisht, afati ligjor 3-ditor skadoi më 27.03.2026. Vendimi i AK-së u nxor më 30.03.2026

Neni 108/A, Paragrafi 6 i LPP-së parashikon mundësinë e vetme ligjore përmes së cilës AK mund të vendosë pas ditës së tretë: duke njoftuar me shkrim ankuesin për zgjatje të afatit, brenda afatit 3-ditor origjinal. Ky njoftim duhet lëshuar jo më vonë se 27.03.2026.

AD-STAR sh.p.k. konfirmon dhe dëshmon se nuk ka marrë asnjë njoftim nga AK-ja — as me shkrim, as me email, as nëpërmjet platformës elektronike të prokurimit — për zgjatje të afatit të rishqyrtimit sipas Paragrafit 6 të Nenit 108/A, brenda afatit 3-ditor ligjor (23.03–27.03.2026).

Kjo shkelje përbën cenim të të drejtës për mjet juridik efektiv dhe e bën vendimin absolutisht të pavlefshëm.

3.2 Shkelja e Nenit 7 LPP — Barazia në Trajtim (par. 1, 2 dhe 3)

AK është i obliguar ligjërisht të sigurojë trajtim të barabartë, jo-diskriminim dhe transparencë ndaj të gjithë operatorëve ekonomikë. Aplikimi i Udhëzimit Administrativ nr. 16/2016 si kriter eliminimi — pa qenë ky akt pjesë e dosjes — e vendos AD-STAR-in dhe çdo operator tjetër në

pozitë të pabarabartë, duke cenuar drejtpërdrejt transparencën e procedurës dhe konkurrencën e drejtë.

3.3 Shkelja e Nenit 27 LPP — Dosja e Tenderit (par. 1)

Dosja e Tenderit duhet të përmbajë të gjitha kriteret dhe kërkesat që do të përdoren gjatë vlerësimit.

Udhëzimi Administrativ nr. 16/2016 nuk figuron në asnjë pjesë të Dosjes së Tenderit dhe nuk iu është bërë i njohur operatorëve ekonomikë si kërkesë e detyrueshme para dorëzimit të ofertave. Sipas Rregullave dhe Udhëzuesit Operativ të KRPP-së (RRUOPP), "dosja e tenderit duhet të përgatitet në mënyrë të tillë që të mos ketë nevojë për informata sqaruese shtesë" dhe "kërkesat e përcaktuara në dosjen e tenderit dhe në njoftimin për kontratë duhet të jenë identike".

3.4 Shkelja e Nenit 51 LPP — Njoftimi i Kriteve të Përzgjedhjes (par. 1)

Kriteret e përzgjedhjes duhet të përcaktohen paraprakisht, të përfshihen shprehimisht në dosjen e tenderit dhe të jenë të qarta e të barabarta për të gjithë. Kriteri i nostrifikimit të diplomave nuk ka qenë i përcaktuar si kriter përzgjedhjeje në asnjë prej dokumenteve të procedurës. Çdo vendim eliminimi bazuar mbi të është proceduralisht i pavlefshëm.

3.5 Shkelja e Nenit 56 LPP — Dispozitat e Përgjithshme mbi Përzgjedhjen (par. 1 dhe 3)

Refuzimi i një oferte është i ligjshëm vetëm kur ajo nuk përmbush kërkesat e specifikuar në dosjen e tenderit. Oferta e AD-STAR-it është refuzuar mbi bazën e një kushti që nuk ekziston në dosje, gjë që e bën refuzimin krejtësisht të pabazuar dhe të paligjshëm.

3.6 Shkelja e Nenit 59 LPP — Ekzaminimi dhe Vlerësimi i Tenderëve (par. 4)

Vlerësimi i ofertave duhet të bëhet vetëm mbi bazën e kriteve të publikuara. Sipas Paragrafin 4 të Nenit 59, përdorimi i Udhëzimit Administrativ nr. 16/2016 — i cili nuk është pjesë e dokumenteve të tenderit — përbën tejkalim kompetencash dhe vlerësim të paligjshëm. AK nuk mund të zëvendësojë kërkesat e dosjes me interpretime administrative të ministrive të tjera, të cilat nuk kanë fuqi normative detyruese në procedurat e prokurimit.

3.7 Arsyetimi i AK-së është i pagëndrueshëm dhe vetë-kundërshtues

Autoriteti Kontraktues, në arsyetimin e tij, thekson se është bazuar në një "interpretim" të marrë nga Ministria e Arsimit, Shkencës, Teknologjisë dhe Inovacionit lidhur me vlefshmërinë e diplomave të panostrifikuara. Ky pretendim jo vetëm që nuk e justifikon vendimin e eliminimit, por përbën një shkelje të rëndë të parimeve të prokurimit publik.

Së pari, një "interpretim" administrativ i marrë nga një institucion tjetër nuk përbën burim të së drejtës që mund të përdoret si kriter vlerësimi në një procedurë prokurimi. Në mungesë të përfshirjes së tij në dosjen e tenderit, ky interpretim mbetet një akt i brendshëm administrativ, pa efekt detyrues ndaj operatorëve ekonomikë dhe i pazbatueshëm si bazë për eliminim.

Së dyti, mbështetja në një interpretim të pa publikuar dhe të panjohur për operatorët ekonomikë përpara dorëzimit të ofertave përbën përdorim të kriteve të fshehta, në kundërshtim të drejtpërdrejtë me parimet e transparencës, barazisë dhe parashikueshmërisë juridike të garantuara nga neni 7 i LPP-së.

Së treti, fakti që Autoriteti Kontraktues ka kërkuar interpretim pas dorëzimit të ofertave dhe e ka përdorur atë për të justifikuar eliminimin, tregon se kriteri në fjalë nuk ka qenë i qartë, i përcaktuar dhe i publikuar paraprakisht, siç kërkohet nga nenet 27 dhe 59 të LPP-së. Një kriter që lind pas hapjes së ofertave nuk mund të përdoret për të penalizuar operatorët ekonomikë.

Së katërti, fraza e përdorur nga Autoriteti Kontraktues — “ju rekomandojmë t’i lexoni ligjet tjera” — është e papranueshme si në aspektin profesional, ashtu edhe në atë juridik. Kjo deklaratë:

- është e pasaktë në thelb, pasi i referohet një akti që nuk është ligj
- zhvendos në mënyrë të padrejtë barrën nga Autoriteti Kontraktues tek operatori ekonomik;
- pranon në mënyrë implicite mungesën e qartësisë dhe të plotësisë së dosjes së tenderit;
- bie ndesh me detyrimin ligjor të Autoritetit Kontraktues për të përcaktuar qartë dhe në mënyrë të plotë të gjitha kriteret e vlerësimit në dokumentet e procedurës.

Në procedurat e prokurimit publik, nuk është detyrë e operatorëve ekonomikë të “hamendësojnë” apo të interpretojnë kërkesa të paqarta apo të papublikuara, por është detyrim i Autoritetit Kontraktues që të sigurojë transparencë të plotë dhe kriteret e qarta, të aksesueshme dhe të barabarta për të gjithë.

Për rrjedhojë, arsyetimi i Autoritetit Kontraktues jo vetëm që nuk e justifikon vendimin e eliminimit, por përbën provë shtesë të shkeljes së parimeve themelore të prokurimit publik dhe të dispozitave të Ligjit për Prokurimin Publik.

3.8 Praktikë e mëparshme të AK

Gjithashtu, është thelbësore të theksohet se në asnjë nga procedurat e mëparshme të prokurimit të zhvilluara nga Ministria e Kulturës, Rinisë dhe Sportit, ku AD-STAR sh.p.k. ka marrë pjesë dhe ka dorëzuar oferta, kriteri i nostrifikimit të diplomave nuk ka qenë kurrë një kriter eliminimi. Kjo tregon se Autoriteti Kontraktues ka aplikuar një praktikë të pabarabartë dhe të paparashikueshme ndaj operatorit ekonomik.

Vendosja e këtij kriteri si bazë eliminimi në këtë procedurë specifike (ku AD-STAR ka paraqitur cmimin me të ulët në 3 lote), pa e pasur të përfshirë në dokumentacionin e tenderit dhe pa e njoftuar operatorët paraprakisht, krijon një situatë të paparashikueshme dhe arbitrare. Kjo shkel qartë nenin 7 të LPP-së për barazinë në trajtim dhe transparencën e procedurës, si dhe nenin 27 dhe 59, të cilët kërkojnë që kriteret e përdorura për vlerësimin dhe eliminimin e ofertave të jenë të publikuara dhe të qarta për të gjithë operatorët ekonomikë.

Praktika konsistente e AK, në të kaluarën, që nuk e ka përdorur kurrë këtë kriter si bazë eliminimi, forcon argumentin se vendimi për eliminimin e AD-STAR sh.p.k. është i papranueshëm dhe duhet të shpallet i pavlefshëm.

IV. DËMI MATERIAL

"Vendimi i paligjshëm i AK-së ka shkaktuar dëm të drejtpërdrejtë dhe të dokumentueshëm ndaj AD-STAR sh.p.k. Vlera totale e Loteve 1, 2 dhe 3 — ku AD-STAR kishte çmimin më të ulët dhe ishte i vetmi ofertues — arrin në 610 359 EUR. Dëmi material i shkaktuar korrespondon me fitimin e munguar që rrjedh nga ekzekutimi i këtyre kontratave, i cili do të përcaktohet me saktësi në fazën përkatëse procedurale. AD-STAR rezervon të drejtën për të kërkuar kompensim të plotë sipas Nenit 118 të LPP-së nëse ankesa aprovohet."

NE PERFUNDIM THEKSOJME SE:

- Në dosjen e tenderit nuk është parashikuar si kriter i kualifikimit njehsimi i diplomave.
- Sipas ligjit për prokurimin publik, autoriteti kontraktor nuk mund të vendosë kriteret shtesë që nuk janë të publikuara paraprakisht.
- Udhëzimi Administrativ nr. 16/2016, që Autoriteti kontraktues ka përdorur si

bazë për eliminim, nuk është përmendur në asnjë pjesë të Dosjes së Tenderit dhe nuk është bërë kërkesë paraprake për operatorët ekonomikë.

- Eliminimi për një kusht të paqartë dhe të papërmendur bie ndesh me parimin e transparencës, barazisë, konkurrencës së drejtë dhe përdorimit efikas të fondeve publike.

V. KËRKESA

Në bazë të Nenit 109 dhe dispozitave përkatëse të Ligjit Nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik (i ndryshuar), AD-STAR sh.p.k. kërkon nga OSHP-ja:

1. Pranimin e kësaj ankese si të afatshme, të plotë dhe të bazuar në ligj;
2. Pezullimin e menjëhershëm të procedurës së prokurimit deri në zgjidhjen e ankesës, konform Nenit 112 LPP;
3. Konstatimin e shkeljes së Nenit 108/A, Paragrafëve 3 dhe 6, si shkelje procedurale e rëndë e AK-së;
4. Shpalljen e Vendimit të AK datë 30.03.2026 si të paligjshëm, të pavlefshëm dhe anulimin e tij;
5. Ri-vlerësimin e ofertave të AD-STAR sh.p.k. pa aplikimin e kriterit të nostrifikimit të papublikuar në dosjen e tenderit;
6. Çdo masë tjetër korrigjuese dhe sanksionuese ndaj AK-së që OSHP-ja e konsideron të nevojshme.

VI. DOKUMENTET BASHKËLIDHUR

1. Vendimi i AK-së për refuzim, datë 30.03.2026, nënshkruar nga Valbone Zekaj, Zv. Drejtore;
2. Kërkesa për Rishqyrtim e dorëzuar nga AD-STAR, datë 23.03.2026 (Formulari F02);
3. Njoftimi i eliminimit nga AK, datë 19.03.2026;
4. Procesverbali i hapjes publike të tenderëve
5. Dëshmia e pagesës së tarifës 6104 Eur qe perben 1% te shumes 610 359 EUR (shuma e ofertave per lotet 1,2,3), në përputhje me kërkesat ligjore për paraqitjen e ankesës pranë OSHP-së.

Bazuar në shkeljet e rënda procedurale dhe materiale të dokumentuara, AD-STAR sh.p.k. kërkon me respekt shqyrtimin e kësaj ankese dhe rivendosjen e ligjshmërisë në këtë procedurë prokurimi.

Me respekt,

 
Alfred Çoma

Përfaqësues i Autorizuar — AD-STAR sh.p.k.

Tiranë, 03.04.2026

Bazë ligjore: Neni 109 i Ligjit Nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik (i ndryshuar me Ligjin Nr. 04/L-237, Nr. 05/L-068 dhe Nr. 05/L-092). Afati i dorëzimit: 10 ditë pune nga publikimi i vendimit të AK (30.03.2026), deri më 09.04.2026.